

Pasoja të Shmangies

JU DHE PROKURORI DUHET TË BINI DAKORD PËR LLOJIN E MASËS SË SHMANGIES

Kur zbatohet masa e shmangies prokurori vendos:

- Të mos fillojë hetimin;
- Të rrëzojë akuzat.
- Të pezullojë hetimin derisa i mituri të përmbushë masën e shmangies.

Mospërmbushja e Masës Alternative

Nëse i mituri, me dashje, nuk e përmbush masën, prokurori mund të vendosë:

- Revokimin ose lënien në fuqi të vendimit për shmangien nga ndjekja penale;
- Ndryshimin e llojit të masës së shmangies;
- Zgjatjen e kohës së marrëveshjes.

Kompesimi i Viktimës

Viktima ka gjithmonë të drejtë për kompensim për dëmin. Juve mund t'ju duhet të paguani edhe nëse ndaj jush është zbatuar masa e shmangies.


Shembuj të veprave penale për të cilat zbatohet shmangia:

- Plagosje e lehtë;
- Dëmtime me dashje;
- Vjedhja;
- Falsifikimi i dokumenteve;
- Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt etj.

Prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, do t'ju njohë me masën e dënimit e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.



Informacion për SHMANGIEN NGA NDJEKJA PENALE



Çfarë është Shmangia



Nëse je i mitur dhe policia gjyqësore ose prokurori dyshon që ke kryer një krim të lehtë, ndaj teje mund të zbatohet masa e shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi.

Shmangie do të thotë që nëse je fajtor nuk do të paguash gjobë apo nuk do të shkosh në burg.

Në vend të këtyre, duhet të biesh dakord me prokurorin për atë që duhet të bësh. Mund të urdhërohesh që të kthehesh në shkollë, ose të takosh dikë nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve.

Kur zbatohet shmangia?

1. Kur ke kryer një vepër penale për herë të parë;
2. Dënimi që mund të caktohet për veprën penale është deri në 5 vjet burg ose gjobë.

Procedurat e Shmangies

Kush e kërkon ose inicion masën?

- I mituri;
- Prokurori;
- Gjykata;
- Punonjësi social ose psikologu.

Kush vendos?

Organ kompetent për dhënien e masës së shmangies nga ndjekja penale janë:

- Prokuroria
- Gjykata

Kur merret vendimi?

Prokurori mund të vendosë të zbatojë masën e shmangies ndaj teje, deri para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes. Kjo do të thotë sapo policia gjyqësore i dërgon raportin prokurorit ose kur hetimi është duke u zhvilluar. Nëse prokurori e dërgon çështjen në gjykatë, Gjykata mund të vendosë të zbatojë masën e shmangies.

PËLQIMI ËSHTË I DETYRUESHËM

Masa e shmangies jepet vetëm me pëlqimin tënd me shkrim. Kjo do të thotë që duhet të firmosësh një dokument ku shprehesh që jep pëlqimin për masën.

Ti ke të drejtë të tërhiqesh në çdo fazë. Avokati yt mbrojtës mund të të flasë më shumë në lidhje me këtë.

Garanci për Shmangien

Prokurori ose gjykata duhet të të informojnë detyrimisht ty dhe mbrojtësin, dhe sipas rastit përfaqësuesin ligjor, lidhur me:

- Konceptin e shmangies nga ndjekja penale;
- Kohëzgjatjen e saj, kushtet dhe mënyrën e zbatimit;
- Pasojat në rast mospërbushjeje të masës së shmangies.

Mund t'i kërkohet avokatit që të të shpjegojë së çfarë do të thotë kjo.

Masat alternative që jepen për shmangien nga ndjekja penale mund të përfshijnë:

- ♦ Programet e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit, sipas të cilit të miturit mund ti kërkohej:
 - të pranojë dhe të tregojë se e kupton përgjegjësinë për veprën penale dhe të pasojës që i ka shkaktuar viktimës;
 - të kompensojë dëmin e shkaktuar viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë;
 - t'i kërkojë falje viktimës; dhe
 - të ndër marrë veprime të pranueshme edhe nga viktimata ose/dhe komuniteti.
- ♦ këshillimin për të miturin dhe familjen;
- ♦ paralajmërimin me gojë;
- ♦ paralajmërimin me shkrim;
- ♦ masat detyruese;
- ♦ vendosjen nën kujdes.

Ndaj teje mund të merren disa masa njëkohësisht. Prokurori ose avokati mbrojtës mund të të shpjegojnë si funksionon.